

Mbi ndërhyrjet në tregun e parasë dhe në tregun valutor gjatë tremujorit të dytë të vitit 2017

1. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E PARASË GJATË TREMUJORIT TË DYTË TË VITIT 2017

1.1. Operacione të tregut të hapur

Tabelë 1: Veprimet e përkohshme të tregut të hapur (në milionë lekë¹.) Burimi: Banka e Shqipërisë.

DATA	R/REPO njëditore	R/REPO njëjavore	R/REPO >1javë <3muaj	REPO njëditore
06-prill-17		17,990.00		
13-prill-17		20,760.00		
20-prill-17	2,420.00	26,000.00		
21-prill-17	7,230.00			
24-prill-17			4,850.00	
27-prill-17		24,700.00		
04-maj-17		17,800.00		
11-maj-17		20,840.00		
18-maj-17		22,640.00		
23-maj-17				3,713.00
24-maj-17			5,000.00	
25-maj-17		21,380.00		
01-qershor-17		17,500.00		
08-qershor-17		21,200.00		
15-qershor-17		23,690.00		
22-qershor-17		21,200.00		
27-qershor-17			4,800.00	
29-qershor-17		18,100.00		

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2017, Banka e Shqipërisë ka ndërhyrë në tregun e parasë nëpërmjet operacioneve të tregut të hapur për injektim likuiditeti. Ndërkohë, me qëllim administrimin e portofolit të saj të bonove të thesarit ka kryer veprime në treg sekondar.

Likuiditeti i injektuar në sistemin bankar rezultoi në rreth 32.32 miliardë lekë, 2.4 miliardë lekë më i lartë krahasuar me tremujorin e parë të vitit.

Në funksion të operacioneve për injektim likuiditeti, Banka e Shqipërisë ka përdorur instrumentin e saj kryesor, marrëveshjen e anasjelltë të riblerjes me maturim njëjavor, për injektim të përkohshëm të likuiditetit për mesatarisht 20.3 miliardë lekë kundrejt 20.9 miliardë lekëve në tremujorin e parë të 2017-së. Në kushtet e rritjes së

deficitit të likuiditetit, janë rinovuar shuma më të larta të marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes me maturim 3-mujor (3 periudha të mbajtjes së Rezervës së Deyrueshme) për mesatarisht 10.5 miliardë lekë kundrejt 9.4 miliardë lekëve gjatë tremujorit të mëparshëm.

Operacioni rregullues për injektim njëditor është përdorur në 3 raste për 2.6-7 miliardë lekë, për të plotësuar mungesën e likuiditetit në sistem më të lartë se pritjet. Këtë tremujor pati edhe një operacion rregullues me

¹ Shifrat janë në vlerë nominale.


² Shifrat janë në vlerë likuiditeti.

Mbi ndërhyrjet në tregun e parasë dhe në tregun valutor gjatë tremujorit të dytë të vitit 2017

qëllim absorbimin e likuiditetit të tepërt të sistemit bankar në fund të periudhës së rezervës së detyruar në muajin maj për 3.7 miliardë lekësh.

Mbi ndërhyrjet në tregun e parasë dhe në tregun valutor gjatë tremujorit të dytë të vitit 2017

Grafik 1: Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë në vitin 2017 (me vlerë nominale). Burimi: Banka e Shqipërisë.



Në funksion të maturimeve të MF-së gjatë këtij tremujori, në emetimet 3 dhe 6-mujore, secila për 1.5 miliardë lekë, si dhe me synim uniformizimin e përqendrimeve të emetimeve në portofolin e saj për momentin në maksimalisht 60%, Banka e Shqipërisë ka kryer blerje të përhershme të bonove të thesarit 12-mujore në tregun sekondar me rezultat neto rritjen e portofolit me 0.1 miliardë lekë kundrejt nivelit të portofolit në fund të 2016-ës.

1.2. Përdorimi i instrumenteve mbështetëse

Depozita njëditore është përdorur për mesatarisht 4 miliardë lekë më pak krahasuar me tremujorin e parë. Shumat e depozituara u luhatën në 0-5 miliardë lekë nga 1.7-6.7 miliardë lekë tremujorin e mëparshëm. Ndërkohë, kredia njëditore është përdorur në vetëm 1 rast në ditën e fundit të periudhës së RD-së për 3.2 miliardë lekë kundrejt 3 rasteve gjatë tremujorit të mëparshëm për 0.8-2.7 miliardë lekë.


2. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR GJATË TREMUJORIT TË DYTË TË VITIT 2017

2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë

Në datën 4 janar 2017, Banka e Shqipërisë ka publikuar kalendarin e blerjes së valutës gjatë vitit 2017 në përputhje me vendimin e Komitetit të Zbatimit dhe Këshillimit të Politikës Monetare të datës 28.12.2016 për të blerë valutë nga bankat e nivelit të dytë me objektiv rritjen e rezervës valutore. Gjatë tremujorit të dytë, janë organizuar 2 prej ankandeve të publikuara për 18 milionë Euro në total. Kalendarin e blerjeve për vitin 2017 paraqitet si më poshtë:

Data	Shuma (mio EUR)
10 Prill	3-8
12 Qershor	3-8
20 Korrik	3-8
11 Gusht	3-8
20 Tetor	3-8
17 Nentor	3-8
15 Dhjetor	3-8

Grafik 2: Ecuria e EUR/ALL dhe USD/ALL në tremujorin e dytë të vitit 2017. Burimi: Banka e Shqipërisë.



2.2 Veprime me institucione të tjera

Në tremujorin e dytë të vitit kanë vazhduar të lidhen marrëveshjet *swap* në valutë kundrejt lekut midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave, sipas kërkesave të kësaj të fundit, që synojnë menaxhimin e likuiditetit të saj në valutë nëpërmjet BSH-së. Në fund të tremujorit të dytë, marrëveshjet e pamaturuara *swap* qenë 190 milionë euro dhe 20 milionë SDR, në nivel pak më të ulët se fundi i tremujorit të parë, kur ato qenë 190 milionë euro dhe 50 milionë SDR. Maturimet e marrëveshjeve *swap* janë zgjatur në 2.5-7.5 muaj kundrejt 1.0-2.5 muajve një tremujor më parë, duke qenë ndjeshëm më të larta se maturimet e zakonshme prej rreth 1 muaji.

Blerjet e valutës nga institucionet e huaja qenë gjithsej 50.00 milionë lekë (Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – IBRD).